

 REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANING			
Njësia Org. Org.Jednica Org.Uni#	58-02	Nr.Prot. Broj.Prot Prot.No	5892-2/25
Nr. i faqeve Broj.stranica No.pages	-05-	Data Datum Date	10.09.2026
PRISHTINE/A			



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	30.03.2026
REFERENC-Ë:	25/5892/MMPHI/468/DMMU
PËR/ZA/TO:	"Italy Recycling" L.L.C. Qendër e mbledhjes, grumbullimit, transportimit, trajtimit fizik, ripërdorimit, përpunimit, magazinimit, dhe riciklimit të mbeturinave të letrës, plastikës, qelqit, mbeturinave metalike dhe vajrave të përdorura, Obiliq.
CC:	Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Arkivës së MMPH-së
NGA/OD/FROM:	Bajram Kafexholli, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPH-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për lëshimin e Lejes Mjedisore

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), ka shqyrtuar kërkesën me Nr.Prot.25/5892/MMPHI, për t'u pajisur me Leje Mjedisore të operatorit "Italy Recycling" L.L.C. për veprimtarinë: Qendër e mbledhjes, grumbullimit, transportimit, trajtimit fizik, ripërdorimit, përpunimit, magazinimit, dhe riciklimit të mbeturinave të letrës, plastikës, qelqit, mbeturinave metalike dhe vajrave të përdorura, Obiliq.

MMPH, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur,
Me respekt!

Faqe 1 nga 5



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 25/5892/MMPHI
Datë: 30.03.2026

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, nenin 9, paragrafët 1 dhe 2 të nenit 10, paragrafët 1 dhe 2 të nenit 11, të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr.04/2022 për Leje Mjedisore, si dhe Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr.01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ MMPHI- Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

Vendim

Aprovohet kërkesa me Nr.Prot.25/8313/MMPHI e kompanisë "Italy Recycling" L.L.C. për t'u pajisur me Leje Mjedisore për veprimtarinë: Qendër e mbledhjes, grumbullimit, transportimit, trajtimit fizik, ripërdorimit, përpunimit, magazinimit, dhe riciklimit të mbeturinave të letrës, plastikës, qelqit, mbeturinave metalike dhe vajrave të përdorura, të specifikuara sipas Katallogut Shtetëror të mbeturinave në tabelën si më poshtë, në ngastrat kadastrale me nr.P-72614055- 01914-6, P-72614055-01914-7 dhe P-72614055-01796-5, Zona kadastrale Obiliq.

Faqe 2 nga 5



Tabelave e kodeve te mbeturinave për të cilat është pajisur me Pëlqim Mjedisor kompania "Italy Recycling" L.L.C., Obiliq				
02 01 04	15 01 09	16 06 02*	17 04 04	20 01 11
02 01 10	15 02 02 *	16 06 03*	17 04 05	
03 03 08	16 01 03	16 06 04	17 04 06	20 01 25
07 02 03*	16 01 04*	16 06 05	17 04 07	20 01 33*
07 02 13	16 01 06	16 06 06*	19 12 01	20 01 34
10 03 05	16 01 07*	16 07 08*	19 12 02	20 01 35*
12 01 07*	16 01 09*	16 08 01	19 12 03	20 01 36
12 01 10*	16 01 17	16 08 02*	19 12 04	20 01 38
13 01 01*	16 01 18	16 08 03	19 12 05	20 01 39
15 01 01	16 01 19	17 01 01	19 12 07	20 01 40
15 01 02	16 01 20	17 02 01	19 12 08	20 02 01
15 01 03	16 02 09*	17 02 02	19 12 12	20 03 01
15 01 04	16 02 14*	17 02 03	20 01 01	20 03 02
15 01 05	16 02 15*	17 04 01	20 01 02	20 03 03
15 01 06	16 02 16	17 04 02	20 01 10	20 03 07
15 01 07	16 06 01*	17 04 03		

Operatori obligohet:

- Të bënë monitorimin e vazhdueshëm të pajisjeve, respektivisht përmbushjes së kërkesave teknike;
- Të mirëmbahet sipërfaqja operationale, e cila është e betonuar dhe izoluar;
- Mbeturinat komunale të vendosen në kontejner dhe të merren nga kompania me të cilën posedoni kontratë;
- Mbeturinat nga procesi teknologjik i prodhimit të merren nga kompania me të cilën posedoni kontratë;
- Të kontrollohet dhe mirëmbahet separatori i vajrave dhe gropa septike, për ta parandaluar ndotjen e tokës dhe ujërave nëntokësore;
- Për sistemin menaxhues mjedisor të këtë personin e profilit mjedisor;
- Nëse gjatë operimit do të këtë ndonjë prishje teknike e që mund të këtë ndikim në mjedis dhe shëndetin e popullatës, të njoftoj MMPH-në;
- Të raportohet për sasinë e grumbulluar, trajtuar dhe ricikluar nga procesi i ndarjes dhe klasifikimit të mbeturinave, raporti t'i dërgohet në MMPH/AMMK;
- Pas përfundimit të aktivitetit të bëhet rehabilitimi dhe rikultivimi i zonës sipas kritereve ligjore dhe përshkrimit në aplikacion;

Arsyetim

Pas shqyrtimit të kërkesës me Nr.Prot.25/8313/MMPHI e kompanisë "Italy Recycling" L.L.C. për t'u pajisur me Leje Mjedisore për veprimtarinë: Qendër e mbledhjes,

Faqe 3 nga 5

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon: + 381 38-200-32-307; <https://mmphi.rks-gov.net/>



grumbullimit, transportimit, trajtimit fizik, ripërdorimit, përpunimit, magazinimit, dhe riciklimit të mbeturinave të letrës, plastikës, qelqit, mbeturinave metalike dhe vajrave të përdorura, Obiliq, në ngastrat kadastrale me nr.P-72614055- 01914-6, P-72614055-01914-7 dhe P-72614055-01796-5, Zona kadastrale Obiliq, MMPH konstaton se operatori i ka **plotësuar** kushtet për t'u pajisur Leje Mjedisore.

Kërkesës për t'u pajisur me Leje Mjedisore i ka bashkangjitur dokumentacionin si në vijim:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr.13/99, të dt.30.09.2022, për përcaktimin e kriterëve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit, NUI 810804204, datë: 15.07.2010, të lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë;
- Pëlqim Mjedisor, Nr.:25/188/1-ZSP/ /25, datë: 20.06.2025, të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;
- Leje Ndërtimore, Nr-8-351-766/2011, datë: 10.05.201, lëshuar nga Komuna e Obiliqit;
- Leje Përdorimi, Nr/ V 3508-4901/2013, datë: 02.09.2013, lëshuar nga Komuna e Obiliqit

Andaj, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), duke u bazuar në nenin 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, andaj bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga pala, gjendjes faktike në terren, mbajtjen e debatit publik, nenit 31 të Ligjit Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, nenin 9, paragrafët 1 dhe 2 të nenit 10, paragrafët 1 dhe 2 të nenit 11, të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr.04/2022 për Leje Mjedisore, si dhe Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr.01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ MMPHI- Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, aprovon kërkesën për Leje Mjedisore.

Leja Mjedisore lëshohet për periudhën pesë (5) vjeçare, në përputhje me paragrafin 4 të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr.04/2022 për Leje Mjedisore.

Leja Mjedisore mund të revokohet, pezullohet apo shfuqizohet në çdo kohë në rast se:

- Pëlqimet apo lejet paraprake mbi bazën e të cilave është lëshuar leja mjedisore janë revokuar, pezulluar apo shfuqizuar;
- Vërtetohet se pala nuk i ka respektuar obligimet e përcaktuara në leje mjedisore;
- Nëse konstatohet se operatori, ka dhënë shënime të pa sakta dhe deklarime të rrejshme;
- Nëse operatori nuk ka zbatuar dispozitat ligjore të legjisllacionin në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Nr.: 25/5892/ZSP/ /26 datë: 30.03.2026

Bajram Kafexhollë

U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPH-së

Vendimi t'iu dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës së Obiliqit;
- DMM-së;
- Divizionit për Leje dhe Licenca Mjedisore;
- AMMK-së;
- Inspektoratit të MMPH-së;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPH-së;
- Arkivit të MMPH-së